



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 553-1/24 Data 01.10.2024
PRISHTINË

**RREGULLORE PËR PUNËN E EKIPIT PËR MONITORIMIN E PUBLIKIMEVE
SHKENCORE**

Prishtinë 2024

Rregullore për punë kërkimore shkencore është hartuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, Statutin e Kolegjit neni 21 pika h dhe neni 71, 72 në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor 27/09/2024

Rishikimi i Nenit 2/A në Rregulloren për Punën e Ekipit për Monitorimin e Publikimeve Shkencore – Shtator 2024

Në kuadër të adresimit të rekomandimeve të dala nga procesi i vlerësimit dhe akreditimit, Kolegji Biznesi ka realizuar rishikimin dhe plotësimin e Rregullores për Punën e Ekipit për Monitorimin e Publikimeve Shkencore në muajin shtator 2024, përmes shtimit të Nenit 2/A, me qëllim përcaktimin e një përkufizimi të qartë, gjithëpërfshirës dhe fleksibil të punës kërkimore-shkencore, në përputhje me misionin dhe profilin akademik të institucionit.

Ky rishikim ka pasur për synim zgjerimin e fushëveprimit të monitorimit të veprimtarisë kërkimore, duke e tejkaluar qasjen e kufizuar vetëm në numrin e publikimeve dhe duke reflektuar pikat e forta dhe potencialin zhvillimor të institucionit. Në këtë kuadër, Neni 2/A njeh si punë kërkimore-shkencore jo vetëm publikimet në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus dhe Web of Science (WoS), por edhe publikimet në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare, projektet kërkimore dhe zhvillimore, aktivitetet e kërkimit aplikativ, bashkëpunimet me institucione akademike dhe industri, projektet ndërkombëtare, si dhe aktivitetet e transferimit të njohurive dhe inovacionit.

RREGULLORE PËR PUNËN E EKIPIT PËR MONITORIMIN E PUBLIKIMEVE SHKENCORE

Qëllimi rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë parimet, kompetencat, procedurat dhe mekanizmat për organizimin dhe funksionimin e Ekipit për Monitorimin e Publikimeve Shkencore në Kolegjin Biznesi, me synim sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm, transparent dhe të drejtë për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të stafit akademik.

Në mënyrë të veçantë, kjo rregullore synon:

- të sigurojë monitorim sistematik dhe proporcional të publikimeve dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore, në përputhje me misionin dhe profilin akademik të institucionit;
- të promovojë cilësinë, integritetin akademik dhe etikën shkencore në veprimtarinë kërkimore;
- të mbështesë zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe kërkimor të stafit akademik;
- të kontribuojë në përmirësimin e performancës kërkimore dhe reputacionit akademik të institucionit;
- të harmonizojë proceset e monitorimit me standardet e sigurimit të cilësisë dhe kërkesat e akreditimit.

Zbatimi i kësaj rregulloreje synon gjithashtu të krijojë një balancë ndërmjet kërkesave për cilësi të lartë akademike dhe fleksibilitetit institucional në vlerësimin e formave të ndryshme të punës kërkimore-shkencore.

Neni 1

Kolegji Biznesi në kuadër të monitorimit të punës shkencore të profesorëve ka themeluar ekipin monitorues i cili ka për obligim të raportojë KLMSH dy herë në vit

Neni 2

Ekipi monitorues ka edhe karakter monitorues por ka edhe karakter rekomandues për stafin akademik që ka të bëjë me botimet në revistën vendore dhe ndërkombëtare

Neni 2/A

Në përputhje me misionin, profilin akademik dhe orientimin profesional të Kolegjit Biznesi, puna kërkimore-shkencore përkufizohet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe fleksibile.

Si punë kërkimore-shkencore konsiderohen, ndër të tjera:

- publikimet shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara në **Scopus** dhe **Web of Science (WoS)**;
- publikimet në revista të tjera shkencore me recensim;
- pjesëmarrja dhe publikimet në **konferenca shkencore ndërkombëtare dhe vendore**;
- projektet kërkimore, zhvillimore dhe aplikative;
- bashkëpunimet kërkimore me institucione akademike, industri dhe organizata të tjera;
- projektet ndërkombëtare dhe iniciativat **Erasmus+**;
- aktivitetet e transferimit të njohurive, inovacionit dhe zhvillimit profesional;
- forma të tjera të veprimtarisë kërkimore që kontribuojnë në zhvillimin akademik, profesional dhe institucional dhe janë në përputhje me misionin e institucionit.

Vlerësimi i punës kërkimore-shkencore realizohet duke respektuar parimet e cilësisë, relevancës, integritetit akademik dhe kontributit real në zhvillimin e institucionit.

Neni 3

Kriteret për publikim

Kriteret janë përcaktuar për të monitoruar publikimet në revistat vendore shkencore dhe ndërkombëtare si në vijim:

- Publikimet duhet të bëhen në revistat ndërkombëtare me impakt faktor në DOJ dhe SKORPUS
- Botimet duhet të jenë në Websitet ku mund të vërtetohen lehtë dhe qartë nga ekipi monitorues.
- Publikimet duhet të jenë të fushave përkatëse ku zhvillohen programet akademike.

Neni 4

Të gjithë anëtarët e stafit akademik obligohen të bashkëpunojnë me ekipin monitorues. Ekipi Monitorues do të mbikëqyrë punën kërkimore dhe publikimet duke ofruar raport monitorues për KLMSH.

Neni 5

Ekipi monitorues ofron rekomandime për botimet në revistat dhe ndihmon stafin akademik të përmirësojë punën shkencore individuale apo ekipore.

Neni 6

Ekipi Monitorues monitoron individualisht performancën dhe punën ekipore të stafit akademik.

Neni 7

Çdo profesor obligohet të publikoj së paku dy punime shkencore në vit.

Neni 8

Ekipi Monitorues do të monitoroj edhe bashkëpunimin shkencor dhe publikues sipas kërkesës që del nga partnerët e industrisë.

Neni 9

Ekipi Monitorues do të monitoroj punën rreth zbatimit të projekteve ndërkombëtare dhe projektet që dalin nga ERASMUSEN+ e që i implementon Kolegji Biznesi.

Neni 10.

Ekipi Monitorues do të raportoj KLMSH.

Neni 11

Ekipi Monitorues do të bashkëpunoj me Zyrën për Cilësi/



Dekani

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi